VENDIM
Nr. 33, datë 28.2.2022

MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË "ENERGY FINANCING TEAM TIRANA" SHPK, ME NR. 390, SERIA F17, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 174, DATË 26.10.2017

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa "d"; nenit 5, pika 1, germa "d", nenit 10, pika 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.2.2022, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 263/4 prot., datë 21.2.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë 'Energy Financing Team Tirana' sh.p.k. me nr. 390, seria F17, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 174, datë 26.10.2017",

konstatoi se:

- Shoqëria "Energy Financing Team Tirana" sh.p.k., mbajtëse e licencës nr. 390, seria F17, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike që nga data 26.10.2017, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, me shkresën e protokolluar në ERE nr. 250 prot., datë 10.2.2022, ka paraqitur kërkesën për të rinovuar licencën në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; dokumentacionin financiar dhe fiskal, dhe dokumentacionin teknik për aktivitetin furnizimit të energjisë elektrike.

- Nga aplikimi është konstatuar mungesë e theksuar e dokumentacionit, si vijon:

Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2:

- germa "d" (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë), plotësuar pjesërisht. Mungojnë vërtetimet e gjykatës dhe prokurorisë për shoqërinë dhe administratorin;

- germa "e" (struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse), plotësuar pjesërisht. Mungon struktura në formë skematike dhe çdo dokument që disponon (marrëveshje/kontratë), në lidhje me shërbimin që ofron për këtë veprimtari grupi inxhiniero-teknik i kompanisë mëmë;

Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3:

- germa "a" (vërtetim për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore), plotësuar pjesërisht. Mungon vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;

- germa "b" (bilanci financiar i tri viteve të fundit), plotësuar pjesërisht. Mungojnë pasqyrat financiare të audituara për vitin 2018;

- germa "c" (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit), pa plotësuar. Mungon dokumentacioni sipas kësaj kërkese;

Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.7:

- germa "b" (kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj); duhet të dokumentojë se cili është kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike; pa plotësuar. Mungon dokumentacioni sipas kësaj kërkese;

- germa "e" (sistemin IT të krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi), pa plotësuar. Mungon dokumentacioni sipas kësaj kërkese;

- germa "g" (dokumentacionin që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t'i ofrohen klientëve), pa plotësuar. Mungon dokumentacioni sipas kësaj kërkese të rregullores;

- germa "i" (niveli i tensionit dhe mënyra e realizimit të matjes për klientët), pa plotësuar. Mungon dokumentacioni sipas kësaj kërkese të rregullores.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për rinovimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike bazuar në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", e ndryshuar.

- Shoqëria "Energy Financing Team Tirana" sh.p.k. ka kryer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI**:**

1. Të mosfillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 390, seria F17, të shoqërisë "Energy Financing Team Tirana" sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 174, data 26.10.2017.

2. Në rast se shoqëria do të paraqesë një aplikim të ri, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijeni e këtij vendimi të Bordit të ERE-s, dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria për qëllime të rinovimit të licencës do të konsiderohet i vlefshëm.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti